

FJALA E DEPUTETIT BLEDAR ÇUÇI

E ENJTE 3 SHKURT 2022

Të nderuar kolegë deputetë,

Sot kemi sjellë për miratim një marrëveshje me fqinjin tonë Greqinë për të ngritur në Kakavijë një qendër të përbashkët të bashkëpunimit policor dhe doganor. Kjo qendër do të rrisë cilësisht bashkëpunimin me fqinjin, por edhe më gjerë sigurinë e kufirit tonë me Bashkimin Europian. Marrëveshja është plotësisht në përputhje me synimin tonë për ta bërë Shqipërinë një vend me kufij të hapur, por të sigurt. Pra, i shërben lëvizjes së lirë të qytetarëve dhe mallrave, duke goditur paligjshmërinë. Ajo lidhet me sigurinë ndërkufitare, luftën kundër trafiqeve, kontrabandën, madje me luftën kundër krimit të organizuar. Po çfarë përmban marrëveshja?! Thelbi i marrëveshjes është ngritja e një qendre të përbashkët ekspertësh nga policia dhe dogana e të dyja vendeve, ku do të shkëmbehet informacion dhe do të bëhet analizë rrisht për të parandaluar veprimtarinë kriminale, kryesisht, krimin ndërkufitar. Shkëmbimi i informacionit mes vendeve është një praktikë tashmë e njohur, por në këtë rast ngritja e një strukture të tillë, unike për nga forma, e lehtëson së tepërmi këtë proces. Nëse dikur në kufijtë mes vendeve tona ngriheshin mure guri, betoni apo gardhe telash me gjemba, sot ne po ngremë struktura të përbashkëta ekspertësh, ku do të shërbejnë policë dhe doganierë shqiptarë e grekë, të cilët do të shkëmbejnë informacion në kohë reale dhe do të analizojnë rreziqet që mund të vijnë nga një individ apo rrjet kriminal, duke shërbyer si katalizatorë të luftës sonë të përbashkët kundër krimit ndërkufitar.

Duhet të mbajmë parasysh, të nderuar kolegë, që qendra në veprimtarinë e saj nuk u mbivendoset autoriteteve policore, doganore përkatëse, por vetëm i asiston ato, i bën më efikase dhe më rezultative. Në punën e agjencive ligjzbatuese informacioni i saktë është ndër kushtet kryesore për rritjen e suksesit. Qendra është në një kuptim si një zyrë “one stop shop”, ku çdo gjë, që ka lidhje me informacionin, procedohet shpejt dhe në mënyrë gjithëpërfshirëse, pasi prej aty ekspertët aksesojnë lehtësisht bazën e të dhënave kombëtare dhe kontaktojnë çdo institucion që posedon një të dhënë të mundshme.

Janë 16 kategori të ndryshme krimesh, për të cilat do të shkëmbehet informacion në bazë të kësaj marrëveshjeje. Kjo flet për rëndësinë që ka për ne, por edhe për palën greke ngritja sa më parë e një strukture të tillë. Ne besojmë se miratimi i aktit të sotëm do të jetë një tregues shtesë i profesionalizmit dhe besueshmërisë së strukturave tona policore në raport me organizatat partnere në rajon dhe më gjerë. Nga ana tjetër, me këtë akt dëshmojmë vullnetin tonë për bashkëpunim sa më thelbësor me vendet mike, partnere dhe mbështetëse të përpjekjeve të vendit tonë për arritjen e synimit tonë madhor: integrimin në familjen e madhe europiane. Të nderuar kolegë, Kjo marrëveshje vjen edhe në një kuadër më të gjerë të vizionit të Ministrisë së Brendshme për të inkurajuar lëvizjen e lirë dhe të ligjshme të shtetasve me kufij sa më të hapur, por, njëkohësisht, sa më të sigurt. Siç edhe jeni në dijeni, ne kemi ndërmarrë edhe disa nisma të bashkëpunimit rajonal që sigurojnë e nxisin lirinë e lëvizjes dhe qëndrimin e lirë e të ligjshëm të shtetasve. Marrëveshjet që kemi nënshkruar së fundmi në takimin vjetor me qeverinë e Kosovës apo marrëveshjet rajonale me mbështetjen e Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal, si dhe marrëveshjet në kuadër të “Open Balkan”, dëshmojnë orientimin pro integrujes të vendit tonë, sidomos në rrafshin rajonal. Paralelisht, ne kemi investuar në drejtim të modernizimit të sigurisë kufitare. Këtë vit, nëpërmjet një projekti që mbështetet nga buxheti i shtetit dhe nga fondet e IPA-s, si dhe me asistencën e partnerëve tanë, do të përsoset modernizimi i kontrollit

të vijës së kufirit dhe shërbimeve të tjera në kufi, nëpërmjet projekteve teknologjike, që janë në proces, si dhe me instalimin e sistemeve përkatëse. Me disa nga shtetet fqinje synojmë digjitalizimin edhe më shumë të kontrolleve kufitare, të pikave të kalimit kufitar, siç është ajo në Morinë-Vërmicë për shtetasit dhe automjetet, duke ndërfaqur sistemet e kontrollit kufitar dhe duke njësuar procedurat. Në lidhje me menaxhimin e trafikut ndërkufitar, strategjia jonë orientohet në ngritjen e pikave të përbashkëta të kalimit kufitar, ku aplikohen procedura të përshpejtuara, çka lehtëson në mënyrë drastike qarkullimin në të dyja kahet me fqinjët tanë.

Përveç aplikimit të këtyre metodave dinamike e të zhdërvjellëta të kontrollit kufitar, ne synojmë dhe po realizojmë konkretisht edhe shtimin e vendkalimeve kufitare, si një nga masat lehtësuese e integruese në favor të shtetasve. Të gjithë këto masa, si dhe marrëveshjet e bashkëpunimit të nënshkruara me fqinjët, me Frontex, apo edhe kjo e sotmja për ngritjen e qendrës së përbashkët policore dhe doganore në Kakavijë me Greqinë janë garanci për mbajtjen dhe ngritjen e parametrave të sigurisë në vend, në rajon e më gjerë, duke garantuar gjithmonë e më shumë arritjen e nivelit të përputhshmërisë me standardet europiane dhe me kërkesat e Shengenit në drejtim të kontrollit të kufijve shtetërorë. Së fundmi, ju ftoj të votoni pro, në mënyrë që përpjekjet tona për rritjen e bashkëpunimit, lëvizjes së lirë dhe sigurisë në vend dhe në rajon të kenë një instrument më tepër në dispozicion, siç është qendra e përbashkët që parashikon kjo marrëveshje. Ju faleminderit!